VENDIM
Nr.118, datë 18.11.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË "CEZ SHPËRNDARJE" SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10 të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të "CEZ shpërndarje" sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014,

konstatoi se:

Aplikimi i "CEZ shpërndarje" sh.a. për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të "CEZ shpërndarje" sh.a., për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011 për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e "CEZ shpërndarje" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani